



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1317 prot.

Tepelenë, më 24.07.2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË ZNJ. JULINDA KARTERI

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e enjte më datë 31.07.2025, ora 10:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”, me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 26.06.2025.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2025.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2025.”
5. **Projektvendim:** “Për detajimin e objektit “Blerje mjete transporti për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, të parashikuara në zërin e shpenzimeve kapitale të Buxhetit të vitit 2025.”
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e projekt dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 (faza e dytë) ”.
7. **Projektvendim:** “Për azhurnimin e hatrës kadastrale për pasuritë nr.124 ZK 3177 ndodhur në fshatin Rexhin Bashkia Tepelenë.”

8. **Projektvendim:** “Për miratimin paraprak të planit të mbarështrimit të ekonomisë pyjore Kurvelesh, pronë e Bashkisë Tepelenë”.
9. **Projektvendim:** “Për miratimin e objekteve prioritare, ndërtimi i info-point, vendparkimi dhe aksesit të rrugës në parkim”.
10. Raportim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike: “Mbi masat e mara për ruajtjen dhe zgjerimin e ambjenteve të gjelberuara në qytet si dhe grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në përputhje me standartet e lejuara, masat që janë marë për sistemimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe atyre publike në Bashkinë Tepelenë”
11. "Informacion mbi rezultatet e Barometrit Gjinnor në Bashkinë Tepelenë, në bazë të legjislacionit shqiptar mbi barazinë gjinore, realizuar nga Aleanca e Grave Këshilltare Bashkiake dhe Komisioni i Barazisë Gjinnore, me mbështetjen teknike të programit Bashki të Forta".
12. Çështje të tjera

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1317/1 prot.

Tepelenë, më 24.07.2025

Lënda: Njoftim për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak .

ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME .

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAZHIMIT FINANCIAR

DREJTORIA LIGJORE DHE SHËRBIME ORGANIZATIVE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË TERRITORIT

DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA ARSIM KULRURËS /KUJDESIT SOCIAL

Ju njoftojmë se mbledhjet e Komisioneve të Përhershme për shqyrtimin e projektvendimeve do të zhvillohen në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

- 1.1 .Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, më datë **30.07.2025 ora 10.00 për pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 të rendit të ditës**

- | | |
|-------------------|------------|
| • Matilda Çela | Kryetare |
| • Latif Kaçaj | N/ Kryetar |
| • Vladimir Gjonça | Anëtar |

- 1.2 .Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut , më datë **30.07.2025 ora 10.00 për pikën 11,të rendit të ditës**

- | | |
|------------------|------------|
| • Mirela Varfi | Kryetare |
| • Marsela Balili | N/Kryetare |
| • Marios Jorgo | Anëtar |

